

**Dr. Taha Xhabir al-Alvani**

# **KORNIZA E NJË STRATEGJIE KULTURORE**

**Nga anglishtja:**

**Mr. Rejhan Neziri**

**Kreuzlingen - 2003**

## Hyrje\*

Zhvillimet në vijim e sipër si dhe një sërë problemesh të mprehta sidomos në planin intelektual me të cilat ndeshet sot Ummeti Islam, paraqesin një sfidë të njëmendtë për Islamin. Këtu qëndron edhe arsyeja se përse është kaq e nevojshme dhe urgjente përpjekja për të skicuar një alternativë intelektuale islame në rrafshin ideor dhe atë shkencor. Kjo, insha'allah, do të na ndihmojë në formulimin e një politike të qartë dhe të koordinuar përsa i përket transformimit kulturor të bazuar në parime të forta e në strategji të shëndoshë. Po ashtu na jep shpresë se kjo politikë do të çojë edhe në përfundime shkencore.

### Gjendja aktuale në rrafshin intelektual

Gjatë shqyrtimit të gjendjes së sotme intelektuale në mesin e popujve muslimanë mund të identifikohen tri tendenca kryesore.

E para mund të karakterizohet si tendencë tradicionaliste e cila, përgjithësisht, mendimin tradicional të Ummetit e konsideron si të vetëmjaftueshëm dhe të aftë për t'u prezentuar ashtu siç është apo edhe me disa ndryshime të vogla. Kjo qasje pretendon se jeta intelektuale e Ummetit ka mundësi të formohet e të organizohet dhe se struktura e qytetërimit të tij mund të ngrihet mbi këtë bazë. Kjo tendencë shpesh quhet edhe *autentike*.

Lëvizja e dytë, mendimin dhe botëkuptimin bashkëkohor të Perëndimit, pra konceptet e tij lidhur me ekzistimin, jetën dhe njeriun, i konsideron si universale dhe se pa këto elemente nuk mund të krijohet ndonjë kulturë dhe qytetërim modern. Kjo tendencë pretendon se mendimi perëndimor duhet të adoptohet në tërësi dhe se çdo aspekt negativ që mund të rezultojë me këtë rast duhet konsideruar si një çmim të cilin gjithsesi duhet paguar në qoftë se dëshirojmë të ngrejmë një kulturë dhe qytetërim modern. Ky botëkuptim ndryshe quhet edhe *modernist*.

Lëvizja e tretë, apo tendenca *eklektike*, ndërkaq, angazhohet për një tjetër botëkuptim. Ajo pohon se duhet selektuar nga mendimi tradicional më të shëndoshën dhe nga ai bashkëkohor 'modern' atë që konsiderohet dhe provohet të jetë e pranueshme dhe që të dyja të shkrihen në një kazan për të formuar një

---

\* Artikulli në fjalë është një ligjëratë që autori e ka mbajtur në Rabat të Marokos në gusht të vitit 1988 si i ftuar i Organizatës Islame për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (ISESCO).

strukturë intelektuale e cila do të sigurojë një bazë të garantuar për arritjen e asaj që e kërkojmë.

Mirëpo, tendenca tradicionaliste, ashtu siç është prezentuar dhe zbatuar në të kaluarën, nuk ka mund ta parandalojë rënien e Ummetit në një gjendje prej së cilës vuan akoma edhe sot. Po kështu, as mendimi perëndimor, ashtu siç është prezentuar e zbatuar, nuk mund ta mbrojë Ummetin nga efektet e tij negative, të dëmshme madje edhe dështuese të cilave nuk mund t'u ikë dot. Dhe së fundi, avokatët e tendencës eklektike – selektive akoma nuk i kanë prezentuar detajet e kësaj përzierjeje që e kanë propozuar, e lëre më të mundohen ta fusin në fuqi. Krejt kjo na detyron ta parashtrojmë pyetjen edhe ashtu mjaft të përhapur: A po përjeton Ummeti një krizë të njëmendtë intelektuale, dhe nëse po, cila do të ishte rruga e daljes nga kjo krizë?

### **Gjendja aktuale në rrafshin shkencor**

Për t'iu përgjigjur pyetjes së sipërshtuar nevojitet një shikim i shkurtër mbi gjendjen aktuale në fushën e shkencës. Studentëve tanë sot u barten dy lloje diturish. Në të parin bëjnë pjesë shkencat bashkëkohore sociale dhe humane si dhe ato teknike e të zbatuara. Të gjitha këto degë shkencore ushtrojnë kontroll dominant mbi organizimin dhe funksionimin e të gjitha aspekteve të jetës. Ato përbëjnë një trup shkencash parimet, rregullat, qëllimet dhe metodat e të cilave janë formuar nga mentaliteti perëndimor përmes kornizës, filozofisë dhe backgroundit të tij fetar dhe intelektual – duke e përjashtuar me këtë rast kontributin e muslimanëve lidhur me bazat e disave prej këtyre degëve shkencore. Çdo aspekt i këtyre shkencave është i lidhur ngushtë me formën perëndimore të qytetërimit.

Në të dytin bëjnë pjesë shkencat të cilat muslimanët i quajnë *Sher'ijeh* (që kanë të bëjnë me Sheri'atin ose të drejtën islame) apo *'aslijeh* (që kanë të bëjnë me bazat e Islamit). Këto shkenca pastaj ndahen më dysh: në qëllimore dhe në instrumentale. Ekspertët e klasifikimit e të katalogizimit të shkencave të dyja këto i fusin nën një titull të përbashkët: *el-'ulum en-naklijeh* ('shkenca të transmetuara').

Shumica e këtyre shkencave janë zhvilluar për t'i trajtuar çështjet e periudhës që ka pasuar atë në të cilën janë themeluar shkencat islame në shek. III hixhrij, si përgjigje ndaj realitetit historik të Ummetit të asaj kohe. Librat dhe punimet burimore që qarkullonin nëpër duart e studentëve të këtij lloji shkencash ishin përgatitur pas mbylljes së *ixhtihadit* (vetëpërpjekjes kreative për nxjerrjen e ligjeve prej burimeve legjitime) dhe përhapjes së *taklidit* (imitimit të veprave të dijetarëve paraprakë). Autorët e këtyre punimeve i përgatitnin ato me kujdesin më të madh duke u kushtuar rëndësi të veçantë imtësirave gjuhësore dhe stilit artistik në mënyrë që studentëve, kolegëve dhe rivalëve të tyre t'ua bënin me dije thellësinë e njohurive që i posedonin. Ato më tepër ishin monologje se sa

vepra didaktike. Metodat dhe përmbajtjet e materialeve të këtilla e mbështesnin konceptin e taklidit dhe e inkurajonin popullin që ta ndiqte atë. Me rëndësi ishte që populli të largohej prej çdo lloji të ixhtihadit e më pas të shkaktonin edhe urrejtjen e popullit ndaj tij. Një shkencë e këtillë, gjithsesi se nuk mund ta përgatiste askënd të përballej me realitetet e jetës. Për më keq, ajo me të madhe e nxiste dhe e promovonte ndjekjen e verbër dhe imitimn e me këtë edhe i dha fund aktivitetit dhe krijimtarisë intelektuale. Prandaj ai që kërkonte dituri ishte i detyruar të zgjidhte ose ndjekjen e mendimeve të huaja bashkëkohore ose t'u bashkangjitej mënyrave të vjetra tradicionale të të menduarit. Ndërkaq asnjëra nga këto shkenca nuk ka mund t'ia mundësojë atij arritjen e ixhtihadit operativ i cili do të mund t'i shërbente si mjet ndihmës në përballimin e problemeve aktuale në një mënyrë të shëndoshë e të përshtatshme.

### **Gjendja aktuale e muslimanëve në fushën e arsimit**

Kur t'i kthehemi sistemit arsimor nëpër botën islame, do të vërejmë se atje sundojnë dy sisteme arsimimi. I pari është 'sistemi islam' tradicional i cili studentëve u ofron një program ku përfshihen edhe shkencat e Sheriatit. Ky system kufizohet në përgatitjen dhe aftësimin e studentëve për punët personale, për mbulimin e nevojave arsimore – edukative, për prirjen në xhami gjatë namazit etj. Pjesa dërmuese e këtij sektori mbetet si punë private që ka një afrim të kufizuar me fondet publike. Paratë e nevojshme për këtë sektor kryesisht sigurohen nga të ardhurat e vakufëve. Atje ku vihen në dispozicion fondet publike, kërkesat për sekularizëm imponohen në emër të 'modernizmit'.

I dyti dhe më i përhapuri është sistemi sekular apo afetar i cili i bart të gjitha llojet e njohurive dhe shkencave bashkëkohore nëpër shkallët e ndryshme të arsimit. Ky sistem proklamon një orientim joislam dhe masa të jashtëzakonshme duke e nxjerrë jashtë loje sistemin islam. Meqë studentët e sistemit islam rrinë anash realitetit dhe sfidave të jetës bashkëkohore, ata si zakonisht nuk paraqesin ndonjë konkurrencë për ata të sistemit sekular. Si rrjedhojë e kësaj pra, është sistemi sekular joislam ai që i kultivon dhe i krijon liderët intelektualë, politikë dhe socialë të Ummetit si dhe menaxherët e shërbimeve të tij dhe të mjeteve të prodhimit.

Si rezultat i kësaj dikotomie, sistemi edukativo – arsimor bëhet mjet ndarjeje i Ummetit dhe i shterjes së energjisë së tij. Në fakt, arsimi dhe edukata duhet të jenë mjete afruese dhe bashkuese të muslimanëve dhe të cilat do t'i pajisnin ata me një perspektivë të përbashkët kulturore e cila do t'i çonte ata drejt progresit dhe konstruksionit. Ato duhet të krijojnë harmoni dhe të sigurojnë një cak të përbashkët dhe kësioji t'i drejtojnë të gjitha forcat drejt zhvillimit të muslimanëve të drejtë mendjet, shpirtërat, sjelljet, dhe fuqitë e iniciativës dhe rezonimit individual të të cilëve janë të shëndosha dhe produktive.

Shumë shfaqje të ndarjes dhe të përçarjes – po bile edhe të konflikteve tragjike – që po e rëndojnë sot botën islame, bartin gjurmët e aspekteve negative të kësaj dikotomie. Krahas kësaj, ekzistojnë edhe efekte negative të disa degëve ‘të posaçme’ të arsimit siç janë ato ushtarake, private dhe të huaja, të cilat reflektohen në qëndrimet dhe në vizionet kulturore të studentëve.

### **Gjendja aktuale e Ummetit në rrafshin e qytetërimit**

Territoret e Ummetit sot bëjnë pjesë në ndër më të rëndësishmet nga aspekti strategjik dhe përfshijnë vendet më të pasura në botë. Ato përmbajnë lëndët e para më të rëndësishme që janë të nevojshme për industrinë perëndimore si dhe resurse të mëdha njerëzore. Muslimanët kanë një trashëgimi madhështore dhe i posedojnë burimet më të mira të udhërrëfimit, respektivisht posedojnë Shpalljen hyjnore (*Vahjin*) me dy pjesët e saj: Kur’anin e paimitueshëm, përfshirë këtu edhe interpretimet dhe zbatimet e tij, si dhe Sunnetin e Muhammedit a.s. Mirëpo, edhe përkundër kësaj, sot bota islame vuan nga ndarjet dhe përçarjet e brendshme, nga turbulenca dhe vetëkontradikta, nga lufta dhe kanosjet për paqen botërore, nga pasuria marramendëse dhe vobekësia tej mase, nga uria dhe epidemitë.

Ummeti është ndarë, përçarë e copëtuar në më shumë se pesëdhjetë shtete – kombe, të ndara me kufij artificialë të disajnuar për krijimin dhe sigurimin e vazhdimësisë së fërkimit, tensionit dhe konfrontimit sidomos midis shteteve fqinje. Asnjëra nga këto shtete nuk ka patur gjasa ta arrijë lirinë dhe stabilitetin e plotë apo integritimin e qytetarëve të saj çka do të mundësonte përqëndrimin e energjive të saj në konstruksion dhe zhvillim. Faktorët e disharmonisë siç janë sektarizmi, frakcionalizmi dhe nacionalizmi kanë qenë aq dominantë sa që kanë krijuar gjendjen e një jostabiliteti dhe brenge të vazhdueshme e cila shumë lehtë ka mund të manipulohet në çdo kohë nga fuqitë e jashtme dhe kësisoji kanë çuar drejt rrëmujës dhe anarkisë. Mungesa e lirisë individuale e pengon ngritjen intelektuale dhe kulturore, si dhe zhvillimin e natyrshëm psikologjik të njerëzve. Muslimani vazhdon të jetojë nën hijen e vobekësisë, shtypjes dhe terrorit pa marrë parasysh nëse këto vijnë nga ata që janë përgatitur veçmas për t’ia imponuar Ummetit format e të menduarit dhe të kulturës perëndimore, apo nga diktatorët ushtarakë të cilët e kanë uzurpuar fuqinë dhe me forcë, torturë dhe frikësim të mendjelehtëve e imponojnë politikën arbitrare dhe kapricioze të një individi. Në regjime të këtilla diktatoriale roli i trupave dhe i institucioneve politike dhe administrative është i suprimuar fare dhe kjo gjendje shkakton rrënimin e të gjitha kualiteteve dhe të potencialit kulturor të njeriut.

Shumica dërmuese e Ummetit është analfabete. Nevojat e tyre i tejkalojnë të mirat, lëndët dhe shërbimet që ata mund t’i sigurojnë. Madje edhe sa u përket nevojave të rëndësishme dhe vitale të jetës asnjë shtet musliman nuk është i vetëmjaftueshëm. Kjo mungesë si zakonisht është shkaktuar nga importi i cili e

rrit varshmërinë ndaj fuqive të huaja. Ajo që situatën e bën akoma më të padurueshme është fakti se lëndët e para blihen prej shteteve muslimane me çmimin më të ulët ose edhe për asgjë, dhe u rikthehen si të mira të fabrikuara me çmimet më të larta. Shumica e këtyre shteteve ballafaqohen me vdekje urie, ndërsa të tjerat mund të reduktohen në një nivel të këtillë edhe atë shumë urgjentisht vetëm nëse kështu dëshirojnë eksportuesit dhe fuqitë e huaja.

Disa shtete muslimane që e kanë ndjekur rrugën e industrializimit nuk kanë mund ta arrijnë vetëmjaftueshmërinë e plotë thjesht ngase kanë qenë të varura nga burimet e huaja sa i përket shumicës së pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e industrive të tyre. Këto burime, pra, posedojnë mundësinë për ta kontrolluar industrinë lokale dhe për ta dirigjuar atë sipas interesave të tyre politike dhe ekonomike.

Në të shumtën e rasteve, ‘industria muslimane’ nuk ka qenë e disajnuar për t’i mbuluar nevojat elementare, urgjente dhe vitale të muslimanëve, por vetëm sa për t’i mbuluar ato të dorës së dytë të cilat do t’i kënaqnin dëshirat dhe shprehitë konsumuese të mbjella te muslimanët në dobi të të tjerëve. Bota islame fatkeqësisht e ka zhvilluar shprehinë e konsumimit të prodhimeve të një qytetërimi të huaj bashkëkohor dhe i ka adoptuar shumë aspekte të jashtme të tij. Ajo, në kryeqytetet e saj ka ndërtuar rrugë, godina dhe vende argëtimi ‘moderne’ sipas stilit perëndimor. Ajo gjithashtu ka ngritur disa institucione politike dhe ekonomike të bazuara në modelet perëndimore. Mirëpo, të gjitha këto masa nuk arritën ta sjellin transformimin e dëshiruar, po as edhe që e kanë vënë Ummetin në rrugën e cila do ta shpiente drejt këtij transformimi. Si mund të tejkalohet kjo?

### **Drejt një alternative islame në rrafshin intelektual**

Për t’ia prezentuar sot Ummetit mendimin alternativ islam, fillimisht duhet që mendimin islam ta rishqyrtojmë në tërësi dhe t’i rivlerësojmë metodat e tij. Ne gjithashtu duhet kuptuar pozitën e mendimit ‘regjional’ dhe ‘nacionalist’ si dhe atë perëndimor, si për nga aspekti marksist ashtu edhe nga ai liberal. Për më tepër, duhet kuptuar shkallën e ndikimit të mendimit të huaj në botën islame me qëllim që të vetëdijësohemi për sfidat e mëdha me të cilat po ndeshemi dhe për presionin që po e ushtrojnë historia dhe e tashmja në mendjet e muslimanëve.

Ekzistojnë një sërë kushtesh të rëndësishme për një reformim të këtillë të mendimit. Para së gjithash, ky reformim duhet të jetë gjithpërfshirës dhe i liruar nga të gjitha shtypjet psikologjike, qofshin këto të së kaluarës apo të kohës më të re; duhet të zbatohet me qëllim të korrigjimit, vetëkritikës dhe kërkimit të njëmendtë të alternativave shkencore të cilat udhëhiqen në bazë të parimeve teorike dhe intelektuale.

Një revizionim i këtillë do t'i nxirrte në pah çështjet kontradiktore të cilat që me kohë e kanë okupuar mendjen e muslimanit dhe të cilat e kanë penguar atë të mos jetë pozitive dhe efektive. Çështje si këto janë kauzaliteti, i ashtuquajtimi konflikt midis shkencave të transmetuara dhe arsyes, imitimi i verbër i disa mendimtarëve me efektet e tij gjymtuese, si dhe dinjiteti i njeriut. Duhet riinterpretuar këto çështje në një formë të shëndoshë dhe objektive dhe duhet kërkuar lirin e mendjes së muslimanit nga prangat dhe efektet negative të këtyre çështjeve që i kanë ushtruar mbi psikologjinë, mentalitetin, arsimin dhe mënyrën e jetesës së tij.

Ne duhet revizuar dhe korrigjuar strukturën e trashëguar kulturore historike dhe t'i shpëtojmë dobësisë, dikotomisë dhe mungesës së realitetit të cilat e pengojnë efikasitetin dhe efektivitetin e saj. Gjithashtu duhet rishqyrtuar të gjitha konceptet mbizotëruese dhe duhet punuar në arritjen e pasqyrimeve dhe perspektivave të qarta për jetën, universin dhe njeriun si dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me këto. Krahës kësaj, ne gjithashtu duhet të bijmë në ujdin e rreth burimeve të këtyre perspektivave dhe të punojmë në disajnimin e sistemeve dhe institucioneve islame duke e përkufizuar me këtë rast rolin e çdonjërit prej tyre, me qëllim që të mund t'i arrijnë objektivat e Islamit edhe pse për nga forma dhe struktura nuk do t'i përgjigjeshin në tërësi realitetit historik. Kjo do të shpiente drejt një koncepti islam për qytetërimin i cili do t'ia mundësonte muslimanit të bënte çmos për ngritjen e Ummetit dhe për arritjen e qëllimeve dhe objektive të tij. Ne duhet të synojmë transformimin e gjithë sa u tha më lartë – sipas një metode të definuar – në një sistem të koordinuar kulturor i cili do ta akulturonte dhe edukonte tërë Ummetin dhe i cili do ta shndërronte atë në një sistem të suksesshëm dhe operativ.

Sipas mendimit tonë, baza e shëndoshë intelektuale e cila është parakusht për ngritjen e një sistemi qytetërues duhet t'i bartë këto tri veçori:

Ajo duhet të posedojë burime të sigurta e të pagabueshme dhe të jetë e mbrojtur nga gabimi dhe devijimi destruktiv në mënyrë që të menduarit të mos shndërrohet në imagjinim dhe në meditim lajthitës; ajo duhet të jetë e pranueshme nga aspekti racional dhe logjik në mënyrë që nëse mendjes së muslimanit i parashtrohen ide të caktuara të mund ajo t'i trajtojë në mënyrë korrekte; dhe së fundi, baza intelektuale duhet të jetë edhe realiste që të mund të bashkëveprojë me realitetin dhe ta transformojë e të ndikojë në të pozitivisht.

### **Drejt një strategjie në rrafshin shkencor**

Sot, njohja shkencore është e definuar sipas kësaj maksime: “Çdo pjesë e njohjes është lëndë e eksperimentit të prekshëm”. Ky përkufizim ka mbizotëruar me shekuj të tërë dhe është pranuar edhe nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO). Ky përkufizim është

përdorur si kriter se cila njohje është shkencore, e cila jo. Përmes adoptimit të këtij koncepti dhe përmes mbështetjes së gjithanshme të tij, Shpallja (*Vahji*) nuk është pranuar si burim i njohjes, i kulturës dhe i qytetërimit. Të gjitha degët e njohjes të bazuara në Shpalljen janë përjashtuar nga fusha e njohjes shkencore pa marrë parasysh nëse ato e kanë trajtuar botën e prekshme apo atë përtej saj. Të gjitha këto fusha të njohjes janë konsideruar të kenë qenë ‘fabula’ apo njohje ‘joshkencore’ pa kurrfarë dobie.

Si rezultat, metoda empirike është konsideruar si mjeti i vetëm për arritjen e njohjes shkencore. Njeriu është numëruar vetëm si një shumësi e substancave biologjike. Shkencat sociale dhe ato humane kanë qenë bërë lëndë e ligjeve të shkencave natyrore. Eksperimentet kanë qenë aplikuar mbi kafshët duke u orvatur t’i definojnë ligjet të cilat do të mund të aplikoheshin edhe mbi njeriun në fushën e sjelljes, përgjegjësisë, reaksionit, ndikimit, bindjes, refuzimit dhe mënyrës së mbulimit të nevojave materiale dhe të tjera si këto.

Edhe muslimanët e kanë pranuar një qasje të këtillë. Si rezultat, shkencat shoqërore dhe humane bashkëkohore, me metoda dhe me një filozofi të këtillë, janë bërë burimet bazë për arsimimin e muslimanit, për formimin e mentalitetit të tij dhe për definimin e qëndrimeve të tij përkitazi me vlerat e së vërtetës dhe të së mirës. Po kështu, edhe artet e bazuara në një filozofi të këtillë janë bërë burim i formimit të psikologjisë së tij dhe i definimit të shijeve dhe qëndrimeve të tij përkitazi me vlerat estetike. Metodatat dhe planet mësimore nëpër universitetet, institutet dhe shkollat kanë qenë lëndë e një qasjeje të këtillë, në ndërkohë që westernizimi dhe tëhuajësimi nga vlerat islame është thelluar gjithnjë e më tepër duke çuar drejt barazimit të Shpalljes me mitin. Ka qenë instaluar një hallkë e fuqishme midis fuqisë, produktivitetit dhe aftësisë së Perëndimit nga njëra anë dhe mendimit të Perëndimit, besimeve dhe koncepteve të tij lidhur me Zotin, universin, njeriun, fenë, jetën, natyrën, kohën, historinë, materien, gruan, shpirtin, shkencën, njohjen dhe me çështje të tjera të ndryshme nga ana tjetër.

Duke u mbështetur në atë sa u tha më sipër, konsiderojmë se hapi i parë drejt formulimit të një strategjie kulturore islame përbëhet nga ridefinimi i njohjes sipas epistemologjisë islame dhe në mënyrë që do të ishte e pranueshme nga të gjithë muslimanët kudo që të jetonin.

Teoria bashkëkohore e njohjes pohon se burimi i vetëm dhe i mundshëm i njohjes shkencore është bota e prekshme. Teoria islame e njohjes shkencore ndërkaq thekson se njohja ka dy burime: Shpalljen dhe botën e perceptueshme. Shpallja është burimi i fakteve dhe i së vërtetës absolute rreth të cilave nuk ka kurrfarë dyshimi dhe ajo (Shpallja) nuk është lëndë e relativitetit. Shpallja është e përmbledhur në Kur’an që është fjala e Zotit e shpallur Muhammedit a.s. All-llahu xh.sh. i ka bërë sfidë njerëzimit për të prodhuar një *sure* (kaptinë) që do t’i përgjigjej së paku një më të shkurte në Kur’an:

*“Dhe nëse dyshoni në atë çka i kemi shpallur robit tonë, atëherë silleni ju një kaptinë të ngjashme me të (Kur’anin), madje thirrni edhe dëshmitarët tuaj, përveç All-llahut, nëse e flisni të vërtetën!” (2 : 23).*

Burimin e dytë të Shpalljes e përbëjnë sqarimet obligative të Kur’anit të përmbledhura në Sunnetin e Muhammedit a.s. i cili përbëhet nga *hadithet* dhe vendimet e tij autentike, gjegjësisht nga krejt ajo që e ka thënë, e ka punuar, e ka aprovuar apo e ka kundërshtuar ai.

Përveç kësaj, teoria islame e njohjes si mjete për arritjen e njohjes i konsideron edhe racion, perceptimin dhe eksperimentin. Në Kur’an thuhet:

*“All-llahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja (si foshnje) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, mbase do të jeni mirënjohës” (16 : 78).*

Sipas Islamit, asnjë informatë nuk mund të quhet njohje e vërtetë apo të jetë e denjë për t’u pranuar po qe se nuk provohet (argumentohet) nga Shpallja apo nga bota e perceptueshme. Njohja që del nga kjo më e fundit do të duhej të derivohej përmes njërës nga tri mjetet e përmendura më lartë e që janë: arsyeya, perceptimi apo eksperimenti. Kur’ani u bën sfidë njerëzve duke u thënë:

*“Sillni argumentin tuaj nëse jeni të sinqertë!” (2 : 111).*

Ata që shprehin një besim të pavërtetuar, ai i pyet:

*“A keni ju ndonjë ‘ilm (njohje, fakt, argument) të na e paraqitni? Ju vetëm për supozimesh mbaheni dhe ju vetëm gënjeni” (6 : 148).*

Dhe kategorikisht pohon:

*“E për atë nuk dinë kurrgjë, pasojnë vetëm hamendjen, kurse hamendja nuk është asgjë ndaj së vërtetës” (53 : 28).*

Dy fushat për të cilat njeriu duhet të dijë e të kuptojë diçka janë: bota ‘e padukshme’ (‘*alemu`l-gajb*), respektivisht krejt ajo që është përtej kapjes së perceptimit të qenieve të krijuara; dhe bota ‘e dukshme’ (‘*alemu`sh-shehadeh*), pra, krejt ajo që mund të dëshmohet përmes shqisave dhe racios së krijesës. Burimi primar për botën ‘e padukshme’ është Shpallja, ndërsa për atë ‘të dukshmen’ është bota e prekshme. Eksperimentet dhe perceptimi, të cilat mund ta mbështesin njëra-tjetrën, sigurojnë prova për botën ‘e dukshme’ përmes mjeteve të ndryshme. Nëse ne hedhim një themel të shëndoshë për teorinë islame të njohjes dhe e prezentojmë atë si një alternativë për atë perëndimore, me këtë do ta kemi vendosur bazën e dytë të strategjisë kulturore të propozuar.

Kjo strategji duhet të lindë nga të kuptuarit se çdo popull ka një çështje kryesore interesimi, një besim apo një qëllim kryesor i cili e pajis atë me motivim, inspirim dhe nxitje në të gjitha fushat e njohjes e të punës. Zakonisht, secili komb shikon ta mbjellë këtë besim apo qëllim në vetëdijen e rinisë së tij duke i përdorur të gjitha metodat e mundshme sidomos në fazën e fëmijërisë. Ai

vazhdon ta ushqejë e ta forcojë këtë besim në të gjitha fazat e tjera të zhvillimit të individit.

Sistemi i sotëm arsimor në botën islame e ka lënë pas dore mbjelljen dhe kultivimin e një besimi të këtillë si dhe të vizioneve, standardeve apo motiveve të shëndosha të rinjtë muslimanë. Si rezultat i kësaj mospërfilljeje, sot, qëllimi i arsimit për të riun musliman është bërë fitimi i një pune të përshtatshme me të ardhura të përshtatshme. Materializmi është përhapur mjaft ndër studentët të cilët e kanë humbur çdo ndjenjë të një qëllimi të qartë në jetë. Planet dhe programet akademike e kanë lënë pas dore ngulitjen e një qëllimi të shëndoshë në ndërgjegjen e të riut musliman. E vetmja rrugë për ta arritur këtë është vendosja e një besimi të shëndoshë islam (*akideh*) dhe mbjellja e një vizioni të qartë islam në zemrat dhe mendjet e të riut musliman. Ne duhet t'i shfrytëzojmë të gjitha mjetet dhe burimet e mundshme për kultivimin dhe zhvillimin e këtij besimi dhe vizioni me qëllim që ta arrijmë ndjenjën e përkatësisë ndaj Ummetit islam. Këtë besim duhet bërë motivim dhe inspirim për mendimet dhe ndjenjat tona.

Shkollat e mesme në Perëndim, përkundër sekularizmit perëndimor, nxënësve të vet ua mësojnë trashëgiminë, historinë kulturore dhe traditat perëndimore në mënyrë të integruar dhe gjithpërfshirëse. Kjo të nxënësit e mbjell ndjenjën e përkatësisë si dhe qëllimet kryesore dhe strategjinë e kombit të tyre. Ata rriten me këtë ndjenjë dhe e bartin me vete vizionin e kombit të tyre si dhe konceptet e tij lidhur me jetën, gjithësinë, njeriun, kulturat e tjera bashkë me aspektet tjera të botëkuptimit të tij.

Strategjia kulturore që po e propozojmë duhet ta inkorporojë Islamin dhe vizionin e tij, jo përmes orëve të caktuara mbi 'religjionin', por përmes tërë sistemit arsimor. Çdo program arsimor duhet të synojë formimin dhe ngulitjen e këtij besimi; ndërsa ne duhet ta pastrojmë çdo një program të këtillë arsimor nga çdo gjë që është kontradiktore dhe bie ndesh me këtë besim. Kjo do të mund të bëhej përmes riorganizimit të sistemit arsimor në të gjitha vendet islame dhe përmes flakjes së ndikimeve negative të dallueshmërisë midis arsimit fetar, sekular, civil dhe ushtarak. Një dallueshmëri e këtillë ka krijuar ndarjen dhe vazhdon ta përjetësojë atë midis njerëzve tanë aq shumë sa që studentët e shkollave dhe universiteteve 'fetare' bartin ide, mendime dhe koncepte fare të ndryshme nga ata të shkollave dhe universiteteve sekulare apo ushtarake. Ne nuk e dëshirojmë suprimimin e dallueshmërisë dhe të specializimit gjatë procesit arsimor; atë që ne e dëshirojmë është t'i jepet fund segmentimit të njohjes.

Kjo mund të arrihet përmes integritetit të të gjitha sistemeve ekzistuese dhe krijimit të një sistemi të vetëm të bazuar në mësimet, frymën dhe vizionin islam. Sistemi i ri arsimor, programet dhe metodat e tij bashkë me përgjegjësit e tyre do të inspiroheshin nga parimet dhe qëllimet e Islamit. Ata duhet të heqin dorë nga programet e huaja arsimore – si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga metodat – të cilat kanë qenë adoptuar pa mos i marrë në konsideratë nevojat dhe aspiratat specifike të Ummetit tonë. Një sistem i tillë i njësuar arsimor do të

shkaktonte lindjen e një ndjenje misioni me ndihmën e së cilës të arriturat profesionale dhe suksesi material nuk do të konsideroheshin si dobi qenësore e as si cak i arsimit. Ky sistem arsimor patjetër duhet t'i bashkojë idetë, konceptet dhe ndjenjat tona lidhur me të gjitha çështjet kyçe. Nëse pas krejt kësaj futen dallueshmëri në specializimet e ndryshme, atëherë më studentët dhe dijetarët nuk do ta ndjenin veten të izoluar e të tëhuajësuar.

Nëse ky unifikim i sistemit arsimor zbatohet në mënyrë të shëndoshë, atëherë të gjithë studentët e Ummetit do t'i pajisë me nga një hisë të mirë të njohjes islame duke e përqafuar besimin, vlerat dhe qëllimet e Islamit, moralin dhe sjelljen e muslimanit, njoftimin me legjislacionin, historinë dhe qytetërimin islam bashkë me krejt atë që është e domosdoshme dhe qenësore për njohjen bashkëkohore.

Gjatë zhvillimit të një alternative islame në rrafshin intelektual dhe shkencor kujdes të veçantë duhet kushtuar studimit të qytetërimit islam. Ky studim, që do të bëhej sipas një plani të përshtatshëm dhe metodik në të cilin do të kontribuonte një numër i madh i mendimtarëve, pedagogëve dhe psikologëve të zgjedhur muslimanë, konsiderohet si njëra ndër mjetet më të rëndësishme për krijimin dhe kristalizimin e ndjenjës së përkatësisë së individit ndaj Ummetit që do t'ia mundësonte atij ta kuptonte frymën që i ka motivuar stërgjyshërit e tij në arritjen e vlerave të mëdha në fushën e artit e të shkencës si dhe në mendimin politik, social dhe ekonomik. Në të njëjtën kohë ai do t'i kuptonte edhe vuajtjet dhe dhimbjet e tyre, çka do t'ia zhvillonin vetëdijen dhe do t'ia mundësonin ta krahasonte vetveten me popujt dhe qytetërimet e tjera. Studimi i qytetërimit islam do të ndihmojë në krijimin dhe zhvillimin e një vetëdijeje lidhur me trashëgiminë e tij, frymën që e ka formuar dhe i ka dhënë jetë si dhe atë që e dallon këtë qytetërim prej të tjerëve. Kjo gjithashtu do të ndihmojë në zhvillimin e aftësisë për planifikim të ardhmërisë dhe në shikimin përpara. Studimi i qytetërimit islam do të ndihmojë edhe në mbrojtjen e muslimanit nga fshesa e rrymave në konflikt të modernizmit të cilat orvaten të dominojnë mbi të. Është e vërtetë se askush nuk mund t'i ikë stuhisë së modernizmit pa u dëmtuar, përveç atyre që i takojnë njërit prej qytetërimeve garuese i cili një ditë do të karakterizohet si alternativë në ndërkohë që të tjerat do të kenë dështuar dhe do të jenë harruar.

Strategjia jonë e re arsimore duhet të përfshijë edhe planifikimin e një kursi studimesh që bazat, vlerat, burimet dhe qëllimet e Islamit do t'i sqaronte si burime të mendimit, kulturës dhe qytetërimit. Ky kurs do të zgjaste katër vjet brenda fazës së parë të arsimit universitar dhe do ta ndiqnin të gjithë studentët pa marrë parasysh specializimin e tyre. Në të do të trajtohej historia islame, të arriturat historike të qytetërimit islam si dhe veçoritë kryesore të kulturës islame.

Duke vazhduar nga ajo që u cek më lartë, ne duhet që shkencat shoqërore dhe humane si dhe artet t'i prezentojmë nga pikëvështrimi islam. Ne duhet të kuptojmë se metodat dhe teoritë e shkencave moderne humane, sociale dhe të artit kanë qenë formuar në mënyrë që do t'i reflektonin mendimet, besimet dhe strategjitë perëndimore sipas caceve dhe qëllimeve të jetës perëndimore.

Çështjet që kanë të bëjnë me këtë, rrjedhin nga teoritë perëndimore të njohjes. Mirëpo, duke i marrë parasysh të gjitha këto shkenca, vetë njeriu perëndimor ka filluar t'i ndjejë mangësitë dhe paaftësitë e tyre madje edhe në mbulimin e nevojave personale. Këto shkenca aktualisht po ndeshen me një sërë problemesh serioze sa u përket metodave, teorive dhe zbatimit të tyre, ndërsa njeriu perëndimor është duke u përpjekur të gjejë rrugë për korrigjimin e tyre.

Muslimanët kanë nevojë t'i kenë shkencat e tyre humane, sociale si dhe artet të bazuara në besimet e tyre dhe në teorinë e njohjes të derivuar nga burimet e këtij besimi. Nëse arrihet kjo, atëherë nuk do të jetë vetëm muslimani ai që do ta ketë arritur qëllimin e tij në fitimin e njohjes së shkencave humane dhe shoqërore islame të cilat kanë lidhje të ngushtë me vlerat morale. Në të vërtetë, këto vlera do të kontribuonin edhe në arritjen e mirëqenies së përgjithshme të gjinisë njerëzore.

Ky cak do të arrihej përmes studimit të mësimëve Kur'anore dhe të Sunnetit që kanë të bëjnë me të gjitha çështjet shoqërore dhe humane, si dhe përmes klasifikimit të tyre sipas temave të shkencave shoqërore dhe humane, në mënyrë që të siguronin direktiva dhe parime të përshtatshme për shoqëritë tona. Kjo punë do të zbatohet përmes grupeve të hulumtuesve të përbëra prej specialistëve të shkencave humane, shoqërore, të gjuhës arabe si dhe të shkencave Kur'anore e të Sunnetit.

Krahas kësaj, trashëgimia islame bashkë me materialet ekzistuese që kanë të bëjnë me të, qofshin të botuara apo në dorëshkrim, duhen studiuar dhe klasifikuar sipas temave të shkencave të lartpërmendura. Ky klasifikim do të duhej zbatuar në mënyrë precize me qëllim që të dhënat prezente të trashëgimisë islame të mund të ishin në duart e hulumtuesve dhe specialistëve në një formë të përshtatshme dhe autentike. Kompjutorët dhe teknologjia informative do të siguronin një shërbim të paçmueshëm në këtë drejtim. Një studim kritik i mendimit bashkëkohor duhet të ndërmerret me qëllim të zgjedhjes së më të mirës që ka ai. Ky selektim do të bëhet sipas standardeve të definuara qartë. Përfundimisht, nevojitet projektimi i planeve për përdorimin dhe shfrytëzimin e të gjitha këtyre materialeve. Tekstet shkollore që përdoren nëpër kolegje, institute e shkolla të tjera duhen rishikuar me qëllim që ta reflektojnë vizionin islam lidhur me realitetin dhe nevojat e kohës së re. Ato duhen shkruar dhe disajnuar në mënyrë atraktive dhe të përshtatshme për përdorim.

Të gjitha universitetet e botës islame duhet të bashkëpunojnë për arritjen e këtyre synimeve. Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (i themeluar më 1981 në Virxhinia, SHBA, kryetari i së cilës aktualisht është autori i artikullit – sh. p.) i ka trajtuar gjerë e gjerë të gjitha këto çështje dhe shpreh dëshirën që përvojën e tij ta ndajë me secilin që njëmend dëshiron t'u qaset këtyre çështjeve.